



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE SHKODËR

Nr 1331 Prot.

Shkodër, më ²¹ 20.03.2024

Lënda: Njoftim për afishim publik 30 ditore

DREJTUAR :

BASHKISË MALËSI E MADHE

Adresa: Koplik

Sikurse jeni në dijeni për fshatin Pjetroschan po kryhet procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi. Në fshatin Pjetroschan kanë rezultuar 76 kërkesa të depozituara pranë ZV ASHK Malësi e Madhe.

Referuar dokumentacionit të DAMT-së, e administruar pranë Zyrës Vendore Malësi e Madhe, rezulton se fshati Pjetroschan ka qënë pjesë e ish-kooperativës bujqësore Kastrat.

Nga shqyrtimi i kriterëve ligjore ka rezultuar se janë legjitimuar si banorë sipas gjendjes familjare të dt. 13.04.1993 (ju rikujtojme shkresat e Zyrës së Gjendjes Civile me nr.48 prot dt.19.02.2024 dhe shkresës nr.141 prot dt.09.01.2018 të Bashkisë Malësi e Madhe, të cilat informojnë se Gjendja Civile e Njësisë Administrative Kastrat është djegur në vitin 1992, dhe se AMTP janë ndare në bazë të gjendjes familjare të 1993); si dhe paraqitjes së kërkesave brenda afatit 6 mujor nga hyrja në fuqi e ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.Sh" të fshatit 30 subjekte.

Me qëllim saktësimin e sipërfaqes është kryer përcaktimi i normativës në zbatim të pikës 15 të VKM 1182/2020.

Për caktimin e normativës është ndjekur kjo metodologji: referuar Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM-nr. 1182 datë 24.12.2020 "Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit të pronësisë, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore", konkretisht pika 15/b e kësaj VKM-je, hartografi i zyrës ka realizuar nxjerrjen e normativës për frymë, për Fshatin Pjetroschan, ZK.2977, Njësia Administrative Kastrat.

Kjo normativë, është përcaktuar nga përlllogaritja e diferencës, midis:

- tokës së lirë bujqësore (të përcaktuar sipas kriterëve të VKM- 1182/2020), ku si procedurë është nxjerre sipërfaqja e lirë e tokës SHTET, e llojit Arë, Pëmëtores, Vreshte, Ullishte; janë zbritur sipërfaqet e kanaleve vaditëse, rrugëve si dhe llojet e pasurive truall, livadh, përrua (sipas hartës dhe dokumentacionit të DAMT), sipërfaqet e

ndërtimeve dhe trualli funksional i tyre si dhe trojet (sipas ORTOFOTOS), po ashtu dhe sipërfaqja e tokës SHTET e dhënë me AMTP-të nga Komuna Pjetrosan(bazuar në AMTP-të që janë të arkivuara ne Arkivën e ZVASHK Malësi e Madhe, të pa regjistruara akoma).

- **dhe numrit total të banorëve** të përcjellë nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Kastrat me shkresë nr.46 prot dt.16.02.2024, ku numri i banorëve rezulton të jetë 1382 persona.

Sipërfaqe totale aktuale Shtet, tokë bujqësore, sipas regjistrimit fillestarë 6416612 m²
Sipërfaqe Troje, Rruge , Kanale nga perputhja me harten e DAMT 525000m²
Sipërfaqe nga AMTP të aplikuara ne zyren e Malesise se Madhe , që rezultojnë të pa regjistruara 1219365m²

Përlllogaritja ka nxjerrë si rezultat shifrën rreth 3381 m² për frymë

Referuar certifikatës familjare duke marrë në konsiderate numrin aktual te anëtarëve të families rezulton se 3 subjektet e mëposhtëm nuk janë brenda normativës për frymë.
Ndodhur ne këto kushte, subjekteve, në përputhje me piken 15/c dhe pikes 8 të VKM-së 1182/2020 u është kërkuar përcjellja e marrëveshjes noteriale me kufitaret.

1. BENET FRAN ELEZAJ

Me shkresë nr.75/44 prot, dt.07.03.2024 të ZVASHK Malësi e Madhe i është kërkuar përcjellja e marrëveshjes noteriale me kufitaret.

Subjekti i mëposhtem, ka dorëzuar pranë zyrës sonë, deklaratat noteriale me nr. 1344Rep/662Kol për parcelen nr.74; deklaratën noteriale 1345Rep / 663Kol për pasurinë nr.92; deklaratën noteriale nr.1347Rep/665Kol për pasurinë nr.85; deklarata noteriale nr.1348Rep/666Kol për pasurinë nr.201/2/3; deklaratën noteriale me nr.1398Rep/698 Kol për pasurinë nr.69.

2. PASHKO LUIGJ ELEZAJ

Me shkresë nr.75/41 prot, dt.07.03.2024 të ZVASHK Malësi e Madhe i është kërkuar përcjellja e marrëveshjes noteriale me kufitaret.

Subjekti i mëposhtem, ka dorëzuar pranë zyrës sonë, deklaratat noteriale me nr. 1343Rep/661Kol për parcelen nr.201/2/2; deklaratën noteriale 1341Rep/659Kol për pasurinë nr.91/1; deklaratën noteriale nr.1342Rep/660Kol për pasurinë nr.81/1.

3. VIKTOR LUIGJ ELEZAJ

Me shkresë nr.75/40 prot, dt.07.03.2024 të ZVASHK Malësi e Madhe i është kërkuar përcjellja e marrëveshjes noteriale me kufitaret.

Subjekti i mëposhtem, ka dorëzuar pranë zyrës sonë, deklaratat noteriale me nr. 1337Rep/655Kol për parcelen nr.201/2/1.